



---

## OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data 03.09.2024

### PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

#### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** BLERJE PAJISJE LABORATORIKE PËR INSTITUTIN E NDËRTIMIT

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 38000000-5**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 43,942,150** (dyzet e tre milion e nëntëqind e dyzetë e dy mijë e njëqind e pesëdhjetë) **Lekë pa TVSH**, konvertuar në Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë: **440,390.35** (katërqind e dyzet mijë e treqind e nëntëdhjetë pikë tridhjetë e pesë) **euro pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqendruara** në rolin e organit qëndror blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** *Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe ne mbeshtetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen *edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të*

kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, u përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: .....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitetin sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

### 2.3 Kapaciteti teknik

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
  - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
  - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të këtij loti, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Ky kriteri garanton Autoritetin Kontraktor se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një veprimtari ekonomike të sukseshme dhe do të realizojë me sukses kontratën objekt prokurimi.

2. Operatori ekonomik duhet të ketë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi. Në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provohet lidhja ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë edhe dokumente të tjera të cilat i konsideron të rëndësishme për objektin. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me pajisje laboratorike, kërkohet siguri se operatori ekonomik ka mundësi të realizojë me sukses kontratën dhe sipas kërkesës dhe afatit të caktuar nga autoriteti kontraktor, si në rastin kur është prodhues ashtu edhe në rastin kur nuk është prodhues i produktit. Duke marrë parasysh edhe institucionin kërkues Instituti i Ndërtimit është e rëndësishme që autoriteti kontraktor të sigurohet se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë kontratën sipas cilësisë, afatit dhe kërkesës së AK përfitues. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.

3. Për të gjithë artikujt objekt prokurimi duhet të paraqiten katalogë / ose skeda teknike ku të jete markuar malli që ofrohet dhe specifikimet teknike perkatese.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **deklaratë nga prodhuesi/ distributor i autorizuar**, se afati garancisë së mallrave objekt prokurimi është 2 (dy) vjet nga dorëzimi pranë autoritetit kontraktor, si dhe gjatë këtij afati operatori ekonomik merr përsipër me kostot e tij shërbimin e riparimit për defektet e mundshme nga prodhimi.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre pa pagesë.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër instalimin, vënien në punë, kalibrimin pas instalimit, testimin me analiza të pajisjeve si dhe trajnimin e stafit për dy jave sipas specifikimeve teknike.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

6. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;
- ISO 45001:2018 “Mbi sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard (ISO 9001) përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. ( e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë ). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkojë certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos furnizimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme. Gjithashtu AK ka kërkuar që operatorët ekonomikë të interesuar të jenë të pajisur me certifikatën ISO 45001, me qëllim pranimin e ofertave nga OE që zbatojnë rregulla rigoroze sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë, duke qenë se realizimi i objektit të prokurimit mund të shoqërohet me rreziqe në ambientet e punës.

7. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën një inxhinier informatik/ elektrik/elektronik/mekatronik/fizik/ mekanik/ ndertimi të trajnuar, për pajisjet e meposhtme / ose ekuivalente me to
  1. Presa automatike multifunksionale për betonin
  2. Prese për provat në terheqje të çelikut dhe përcaktimin e rezistencës në perkulje të çelikut
  3. Pajisje për testimin e Tombinove.

**Per inxhinierin duhet të paraqitet:**

- Diplomë sipas profilit Inxhinier Informatik/Elektrik/Mekatronik/Fizik/Mekanik/Ndertimi;

- Kontrate individuale pune;
- CV
- Certifikatë trajnimi e lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ose autoritete / ente të tjera, të autorizuar për lëshimin e certifikatave të formimit profesional / ose ekuivalent, në përputhje me natyrën e pajisjeve më sipër në kriterin nr. 7.

*Ky kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** *Ky kriter është vendosur mbështetur në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40 pika 5, gërma “b”, si dhe mbështetur në rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik, administruar me nr. 5168 prot., datë 18.07.2024 “Rekomandim mbi hartimin e kitereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”, sipas të cilit rekomandohet që, përveç certifikatave të lëshuara nga prodhuesi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë që mund të ekzistojnë autoritete/ institucione/ ente të autorizuar të tjera, për lëshimin e certifikatave/ dëshmime të formimit profesional, si dhe ekuivalentet e këtyre certifikimeve, lëshuar nga autoritete të autorizuar ose të certifikuara për dhënien e tyre dhe jo vetëm nga prodhuesi. Kërkesa për të paktën një inxhinier në profilet alternative Informatik/Elektrik/Mekatronik/Fizik/Mekanik/Ndërtimi është njëkohësisht në përputhje me natyrën dhe ndërtimin e pajisjeve të mësipërme, instalimi i të cilave kërkon njohuri të specializuara. Ky kriter është është proporcional, në përputhje me objektin e prokurimit, si dhe i domosdoshëm për të siguruar realizimin e objektit të prokurimit për pajisjet si më sipër.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga autoriteti kontraktues përfitues, sipas nevojave të tyre për blerje pajisje laboratorike për Institutin e Ndërtimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika

38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Shënim:** *Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.*

**NJËSIA E PROKURIMIT**